

Mundësuar nga projekti “ Krijimi i vendeve të punës në bujqësi”

Supported from project “Creating employment in agriculture”

Atlas i disa bimëve mjekësore aromatike që mund të kultivohen <i>Atlas of some medical aromatic plants that can be cultivated</i>			
Nr. No.	Lloji i bimës Plant type	Foto Photo	Përshkrimi Description
1	Mëllaga e zezë <i>Common Mallow</i> (<i>Malva Sylvestris</i>)		Bimë një ose dyvjeçare me kërcell të degëzuar, në lartësi deri në 1.5 m, të gjelbër në maje dhe i drunjëzuar në pjesën e poshtme. Pjesët e përdorshme: Lulja dhe Gjethi. Annual or biennial plant with branched stems, up to 1.5m tall, green at the top and woody at the bottom. Useful parts: Flowers and Leaves.
2	Kalendula <i>Pot marigold</i> (<i>Calendula Officinalis</i>)		Bimë një vjeçare rrallë dy vjeçare, ka lartësi 60-80 cm. Ka rrënjë boshtore me kërcell të drejtë kurse pjesa lartë e degëzuar. Në maje të degëve gjenden lulesat. Pjesët e përdorshme: Lulja. Annual plant rarely perennial herbaceous plant, growing un to 60- 80 cm. Have axial staright roots and the upper part is branched.At the top of the branches are flowers. Useful parts: Flower.
3	Ciani <i>Cornflower</i> (<i>Centaurea cyanus</i>)		Bimë njëvjeçare rrallë dyvjeçare me kërcell të ngritur 20-80 cm, i degëzuar, kanë kërcell të fortë dhe të degëzuar në pjesën e sipërme, disi këndor dhe të mbuluar me qime të lagështa. Pjesët e përdorshme: Lulet, rrallë gjethet. Annual plant rarely biennial with raised stem of 20-80 cm, it has strong and branched stems in the upper part, somewhat angular and covered with lanuginous hair. Useful parts: Flowers and rarely leaves.
4	Kamomili <i>Chamomile</i> (<i>Matricaria Chamomilla</i>)		Bimë e gjelbërt një vjeçare, gjatësia 15-100 cm, kërcelli rritet shpejt dhe degëzohet shumë. Kamomila është bimë e përshtatshme për bletë. Pjesë e përdorshme: Lulja. Annual green plant, with length up to 15 -100 cm, stem grows fast and it branches. Chamomile is a plat suitable for bees. Useful parts: Flowers.
5	Luledielli mjekësorë <i>Medicinal sunflower</i> (<i>Helianthus annuus</i>)		Bimë një vjeçare me gjatësi deri 1 m. Kërcelli rritet shpejt dhe degëzohet shumë duke formuar kokat e lules. Në një kërcell janë të grupuara deri në 15 koka të lules diametri i të cilave është më i vogël se luledielli i zakonshëm. Pjesët e përdorshme: Petalet e luleve. Annual plant up to 1 m long. The stem grows quickly and branches out a lot forming flower heads. In one stalk are grouped up to 15 flower heads whose diameter is smaller than ordinary sunflower. Useful parts: Flower petals.
6	Gentiana <i>Gentiana flower</i> (<i>Gentiana Lutea</i>)		Bimë barishtore shumëvjeçare, 60 - 150cm e lartë, e padegëzuar dhe me rizomë të degëzuar. Përdoren pjesët nëntokësore të përbëra nga rizoma (rrënjët). Pjesët e përdorshme: Rizoma dhe rrënjët që nxirren në vitin e pestë. Perennial herbaceous plant, growing up to 60-150cm tall, unbranched and with branched rhizome.The underground parts are used consisting of rhizome (rootstock). Useful parts: Rhizomes/roots that are harvested in the fifth year.
7	Menta <i>Peppermint</i> (<i>Menta Piperita</i>)		Bimë shumëvjeçare me lartësi 30 - 80 cm trup të degëzuar rrënjë xhufkore dhe lule të imëta me ngjyrë vjollce. Kërcejt janë këndore me gjatësi përafërsisht 60cm. Pjesët e përdorshme: Gjethet. Perennial growing plant with height up to 30-80 cm branched body tufted roots and small purple flowers.The stems of the approx. 60cm tall plant are angular. Useful parts: Leaves.

8	Rigoni i bardhë <i>White Oregano</i> (<i>Origanum Heracleoticum</i>)		Bimë shumëvjeçare që rritet nga 0,6-0,8 m e lartë, ka kërcell të ngurtë druri që mund të kenë ngjyrë vjollce, me sistem rrënjor shumë të fuqishëm, kërcjëtë rriten 60 - 80 cm. Pjesët e përdorshme: Pjesa mbitokësore. Is a perennial growing plant from 0.6- 0.8 m tall, it has stiff woody stems that can be purplish in color, with very strong root system, stems grow up to 60 - 80 cm. Useful parts: Above Ground Parts.
9	Hithëri <i>Nettle</i> (<i>Urtica Dioica</i>)		Bimë barishtore shumëvjeçare 30-150 cm, zakonisht dioike, e mbuluar dëndësisht me qime gjegjëse. Pjesët e përdorshme: Gjethi dhe Rrënja. Perennial herbaceous plant 30-150cm, usually dioic, densely covered with corresponding hairs. Useful parts: Leaves and Roots.
10	Melisa <i>Lemon balm</i> (<i>Melissa Officinalis</i>)		Bimë shumëvjeçare, e gjelbër me lartësi 60 - 80 cm, gjethet janë të renditura njëra kundrejt tjetrës. Gjatë verës shfaqen lule të vogla të bardha plot me nektar. Pjesët e përdorshme: Pjesa mbitokësore. Perennial plant, green it grows to a maximum height of 60–80 cm, the leaves are arranged opposite each other. During summer, small white flowers full of nectar appear. Useful parts: Above Ground Parts.
11	Sherbela <i>Common sage</i> (<i>Salvia Officinalis</i>)		Bimë shumëvjeçare me sistem të zhvilluar rrënjor, kërcjëtë rriten 50 - 80 cm e gjatë dhe e gjerë, mund të jenë gjithashtu të bardha, rozë ose ngjyrë vjollce. Pjesët e përdorshme: Pjesa mbitokësore. Perennial plant with well-developed root system, stems grow approximately 50 - 80 cm tall and wide, though they can also be white, pink, or purple. Useful parts: Above Ground Parts.
12	Mullagë e Zezë <i>Egyptian</i> <i>Hollyhock Flower</i> (<i>Alcea Rosea</i>)		Bimë një ose shumëvjeçare jetë-shkurtër me kërcell të degëzuar, në lartësi deri në 1.5 m, e gjelbër në majë dhe i drunjëzuar në pjesën e poshtme. Bima mund të lulëzojë gjatë vitit të parë kur mbillet herët. Pjesët e përdorshme: Lulja dhe Gjethi. Biennial or perennial plant with branched stem, up to 1.5 m in height, green at the top and woody at the bottom. The plant may flower during its first year when sown early. Useful parts: Flower and Leaves.
13	Mëllaga e bardhë <i>Marsh mallow</i> (<i>Althea Officinalis</i>)		Bimë barishtore shumëvjeçare deri 1.5- 2 m e lartë me rrënjë të gjata dhe të trasha. Lulet kanë formë si ato të mëllagës së zakonshme, por janë më të vogla dhe me ngjyrë të zbehtë. Pjesët e përdorshme: Rrënja, Lulja, Gjethi. Perennial herbaceous plant up to 1.5- 2 m tall with long and thick roots. The flowers are shaped like those of the common mallow, but smaller and of a pale colour. Useful parts: Roots, Flower and Leaves.
14	Shafrani <i>Autumn Crocus</i> (<i>Crocus Sativus</i>)		Bimë barishtore shumë vjeçare me zhardhok si të qepës, me lule ngjyrë vjollce e si hinkë. Është e njohur për prodhimin e shafranit me erëza nga fijet që rriten brenda lules. Pjesët e përdorshme: Pjesët e lules (stigmat). Perennial herbaceous plant with onion-like tuber, purple flowers and funnel. It is best known for producing the spice saffron from the filaments that grow inside the flower. Useful parts: Parts of flowers (stigma).
15	Agulçe e Vërtetë <i>Cowslip</i> (<i>Primula Veris</i>)		Bimë barishtore shumëvjeçare 15-25 cm e lartë, lulet ngjyrë ari ose të verdha. Gjethet kanë formë vezake gjatore, lulesa ombrellë me 5-15 lule, kupa kambanore. Pjesët e përdorshme: Lulet, Rizomet dhe Rrënjët. Perennial herbaceous plant 15-25 cm tall, flowers are golden or yellow. The leaves are elongated ovate, umbrella flowers with 5-15 flowers, bell cup. Useful parts: Flowers, Rhizomes and Roots

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian, apo programit IPA II.

The content therein is a responsibility of the Initiative for Agricultural Development of Kosovo- IADK and shall not be considered as the stance of the European Union, nor IPA II programme.